

# LIRIA NË DEMOKRACI



MUNDËSIA JONË PËR T'U  
SHPREHUR

# TË DREJTAT TONA NË DEMOKRACI

LINA (9), ELDA (9), JONA (9), VERA (9), MAGDALENA (9), MAELI (9), ALISI (9), ERIONI (9)



Në këtë foto ne kemi treguar disa elemente kryesore të demokracisë

## Çka është demokracia

Demokracia është shfaqur në Athinë në vitin 507 para erës sonë. Ajo do të thotë udhëheqje e popullit. Ekzistojnë dy lloje të demokracisë dhe ato janë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Elementet kryesore të demokracisë janë: liria dhe barazia. Barazia do të thotë kur kemi që të gjithë të drejta të barabarta. Ndërsa liria do të thotë kur dikush është i lirë të zgjedh atë që dëshiron.

## RESPEKTI DHE TOLERANCA

Respekt do të thotë të kesh kujdes ndaj prindërve, të moshuarve, mësueses, dhe të gjithë persoave të tjerë afër nesh. Toleranca është kur ne kemi mirëkuptim për njëri-tjetrin.



## TË DREJTAT TONA

Të drejtat tona janë të barabarta dhe disa nga to janë:

- E drejta e shkollohimit.
- E drejta e lojës.
- E drejta e mësimit.
- E drejta e punës.
- E drejta për të shprehur mendimet tona.
- E drejta e bashkëpunimit me njëri-tjetrin
- Ne kemi të drejtë të votojmë.
- Ne kemi të drejtë të jemi të lirë.
- Ne kemi të drejtë të jetojmë në paqe.
- Ne kemi të drejtë të bëjmë gjëra të ndryshme që na pëlqejnë.

Pra, në demokraci ne kemi shumë të drejta dhe mundësi që të shprehim mendimin tonë për atë që ne dëshirojmë.



# VOTË PËR DEPUTETË

GENT (9), KIARA (9), DONAT (9), FILLESA (9), JETA (9), ENDRI (9), RIZUANA (9)

Ne jemi grupi "Molla" nga klasa IV-3, nga shkolla "Faik Konica"




Ne votojmë për të zgjedhur deputet një njeri. Votat tona, të cilat ne iu japim kandidatëve për deputetë, ju lutem të na respektoni. Ne duhet të kemi interesa të njëjta me deputetët. Nëse na trajtoni si duhet edhe ne do t'iu respektojmë ju.

Sot, gjatë Punëtorisë së Demokracisë të gjithë anëtarët e grupit ishim deputetë dhe deputete. Kemi

shkruar programin tonë se si do punojmë për vendin tonë. Pra, ne duam që shteti ynë të jetë më i miri në të gjithë botën. Pasi kemi shkruar programin, e kemi lexuar atë dhe kemi votuar për partinë që na ka pëlqyer më së shumti.

Partia që kishte më së shumti vota ishte Partia Kokosi. Faleminderit shumë për vëmendjen!




Me siguri po. Vota ime ka rëndësi!



A do të dalësh të votosh?

Votoni për Partinë Kokosi dhe programin e saj.




Unë sot kam dalur në zgjedhje dhe jam duke votuar partinë që më pëlqen.





# MËSONI SE Ç'NDODH NË KUVENDIN E KOSOVËS

ERNESA (9), MAL (9), BORI (9), ORIK (9), ELONA (9), LINOR (9), JENA (10), MIGENA (9)



## Republika e Kosovës është me të vërtetë shtet i ri, por është shtet i mirë dhe demokratik


Kuvendi është vend i rëndësishëm ku miratohet dhe përfaqësohet ligji. Detyrat e Kuvendit janë: të kontrolloj Qeverinë, të miratoj ligjin, ashtu siç e cekëm dhe më lart të zgjedh Presidentin, Kryeministrin, etj. Në Kuvend bëjnë pjesë: deputetët, Kryetari i Kuvendit dhe nënkryetarët e tij. Propozimin e ligjeve mund ta bëjnë deputetët, Qeveria, Presidenti dhe 10.000 e më shumë qytetarë.

Në këto momente, Qeveria e Republikës së Kosovës po përpiqet që të rinovoj apo të ndërtoj shkolla ose spitale të reja. Nëse Qeveria nuk punon mirë, atëherë Kuvendi mundet ta shkarkoj atë me anë të votave të deputetëve që punojnë aty.

Në Kuvend ekzistojnë tri mënyra të votimit, ato janë: votimi me duar, votimi në mënyrë elektronike dhe votimi me letra. Kryesia e Kuvendit të Kosovës mbledhet

zakonisht të hënave, kurse seancat plenare mbahen të enjteve. Aty takohen 120 deputetë, 100 nga ata janë të komunitetit shqiptar, kurse 20 janë nga komunitetet jo shumicë.

Kosova është shtet 8 vjeçar dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës po mundohet që Kosova të shkoj drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ligjet të cilat miratohen në Kuvend kanë shumë ndikim në jetërat tona.



Kuvendi i ilustruar



Gazetarët gjatë punës



Autorët e artikullit

# TË JEMI QYTETARË TË NDERSHËM

ARTI (9), EPI (9), ENI (9), LISA (9), NOAR (9), RITA (9), STINA (9), TUANA (9)

Në artikullin tonë do të mësoni më shumë për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve dhe fëmijëve

## ÇKA DO TË THOTË TË JESH QYTETAR?

Të gjithë ata njerëz, të cilët janë të regjistruar në regjistrin civil të Kosovës dhe posedojnë një mjet identifikimi quhen qytetarë. Ne edhe si fëmijë që jemi, si mjet identifikimi kemi çertifikatat e lindjes që na tregojnë që ne jemi qytetarë të Kosovës.

## A DUHET TË JENË TË GJITHË TË BARABARTË?

Po, të gjithë qytetarët duhet të jenë të barabartë në të gjitha rastet, edhe nëse dikush është i zi ose i bardhë, edhe nëse dikush është mashkull ose femër, të gjithë i kemi të drejtat e barabarta.

## SI MUND TË JEMI QYTETARË AKTIV?

Qytetarë aktiv mund të jemi nëse marim pjesë nëpër aktivitete të ndryshme, p.sh. pastrimin e ambientit ku jetojmë, t'i ndihmojmë njerëzit e moshuar ose të varfër, të mësojmë e të rrijmë etj.

## SI MUND TË JEMI AKTIVË NË NIVEL LOKAL?

Ne si fëmijë, mund të jemi qytetarë aktiv edhe në nivelin lokal. Një nga rastet mund të jetë kur ne mbledhemi në grupe të ndryshme dhe vendosim t'i pastrojmë të gjitha lagjet e qytetit tonë, Prishtinës nga mbeturinat e ndryshme.



Edhe pse jo një ngjyrë, të gjithë jemi të barabartë.

Të gjithë duhet të jemi të barabartë.

Këto janë duart e Artit, Noarit dhe Epi

Këto janë duart e Tuanës, Stinës, Lisës, Ritës dhe Enit



Unë jam Stina dhe kam vizatuar një vajzë me disa të drejta.

Rita ka paraqitur një djalë me disa të drejta.

Vizatimi i Stinës

Vizatimi i Ritës





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Faik Konica“  
Klasa: IV-3  
Vendi: Prishtinë